



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.14, datë 28.02.2020

PËR

MIRATIMIN NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË POLIFUNKSIONALE 2, 4, 16 DHE 24 KATE “GARDEN BUILDING”, ME
VENDNDODHJE NË RRUGËN E KAVAJËS, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 48 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; nenit 17, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërive “Tirana 1 Konstruksion” sh.p.k dhe “Nova Construction 2012” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Godinë polifunksionale 2, 4, 16 dhe 24 kate “Garden Building”, me vendndodhje në Rrugën e Kavajës, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana 1 Konstruksion” sh.p.k dhe “Nova Construction 2012” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.5, datë 10.11.2017, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

